



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 610/01-22947 /2020
Kaçanik, 16.09.2020

Në bazë të nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, lidhur me pranimin e mësimeve praktikantë (me pagesë) për gjashtë muaj me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj, në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Komunën e Kaçanikut, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpall këtë:

KONKURS PËR PRAKTIKANTË

Nr.	INSTITUCIONI:SHKOLLAT FILLORE TË MESME TË ULËTA	Numri i Praktikantëve
1.	Mësimdhënës të mësimit klasor	10
2.	Mësimdhënës të lëndës Teknologjisë Informative	4
3.	Mësimdhënës të lëndës Gjuhës shqipe	2
4.	Mësimdhënës të lëndës Matematikë	2
5.	Mësimdhënës të lëndës Gjuhës angleze	1
6.	Mësimdhënës të lëndës Fizikë	1
	Gjithsej:	20

- Pagesa neto për një muaj do të jetë: 280 € (euro).

Detyrat dhe përgjegjësitë për mësimeve praktikantë:

- Të bashkëpunoj me mësimeve që të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës ku është caktuar, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të bashkëpunoj me mësimeve dhe zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimeve;
- Në bashkëpunim me mësimeve, të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimeve dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Në bashkëpunim me mësimeve, të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës

- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs :

Për mësimdhënës praktikant, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstraktin e lindjes, CV- në, letër motivimin dhe kopjen e letërnjoftimit.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar-Zyra e Pranimit, kati përdhes.

Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellët në ditën e intervistimit.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Komisioni për shqyrtimin e konkursit i njofton kandidatët për seleksionim dhe intervistim përmes, postës elektronike (e-mail) ose tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe në Web-faqen e komunës prej 17.09.2020 deri 24.09.2020.

